




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. DPK
 Dep. _____
 Nr. I faq. _____
 Broj stranica 05
 Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
 Br. Prot. _____
 Prot No 03-03/3824
 Data _____
 Datum 19.10.2016
 Date _____

PRISHTINË



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	17/10/2016
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Ismet HYSENI Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë
CC:	z. Ardian Mehmetaj Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	Shaip Havolli, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin “Furnizim me implante për klinikën e Ortopedisë dhe Traumatologjisë Kockore”

I nderuar z. Hyseni,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Furnizim me implante për klinikën e Ortopedisë dhe Traumatologjisë Kockore” me numër të prokurimit 206 16 018 111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik “Furnizim me implante për klinikën e Ortopedisë dhe Traumatologjisë Kockore” me numër të prokurimit 206 16 018 111, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L - 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092

A r s y e t i m

Agjencia kundër Korrupsionit pas pranimit të informates nga operatori ekonomik Ortho-Implants me datën 27.04.2016 ka hapur rastin për trajtim në divizionin e parandalimit me dokumentacion bashkangjites Kërkese për Rishqyrtim nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Ankesa e operatorit ekonomike ka qenë në lidhje me hartimin e specifikave nga ana e Autoritetit Kontraktues. Sipas Operatorit në fjalë me formulimin e tillë të specifikave nga ana e Autoritetit Kontraktues favorizohen prodhues të caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminon prodhues të tjerë. Lidhur me pakënaqësinë e formulimit të specifikave teknike Operatori Ekonomik ka dorëzuar kërkesën për Ri-Shqyrtim edhe pranë Autoritetit Kontraktues-MSH.

Sipas të dhënave që posedon Agjencia, Zyra e Prokurimit pranë Autoritetit Kontraktues-MSH ka kërkuar sqarim nga njësia e kërkesës në lidhje me hartimin e specifikave pasi që ata janë përgjegjës për këtë fushë.

Dhe brenda afatit ligjor Zyra e prokurimit pranë MSH-së ka marrë përgjigjen nga njësia e kërkesës e cila ka hedhur poshtë pretendimin e Operatorit Ankues. Sipas kësaj përgjigje hartimi i specifikave nuk favorizon vetëm një prodhues të caktuar, por janë disa prodhues të njohur botëror të cilët i përmbushin specifikat e tilla. Të njëjtën përgjigje zyra e Prokurimit- MSh i ka dorëzuar Operatorit Ankues- Ortho Implant, pas përgjigjes së marre OE në fjalë nuk ka vazhduar me procedura tjera të ankimimit.

Me të perfunduar faza e parë e ankesës dhe pranimit të përgjigjes Agjencia ka njoftuar Autoritetin Kontraktues- Ministria e Shëndetësisë se do të jetë pjesë e

Monitorimit lidhur me vlerësimin e tenderit me titull "Furnizim me implante për klinikën e Ortopedisë dhe Traumatologjisë Kockore" me numër të prokurimit 206 16 018 111.

Ky aktivitet i prokurimit më datë 24/06/2016 është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së në procedurë të hapur- vlerë e madhe, i ndarë në 5 (pesë) Lote.

Ku për **Lot 1** kemi furnizim me Partial Bipolar HIP Prosthesis, për **Lot 2** kemi furnizim me Screw and Plates, për **Lot 3** kemi furnizim me Instrumentarium needs, për **Lot 4** kemi furnizim me Thoraco Lumbal SPINE dhe për **Lot 5** kemi furnizim me Spine Classic Instruments.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka marr pjesë në cilësinë e monitoruesit në vlerësimin e tenderëve dhe ka shqyrtuar me kujdes të gjitha dokumentet e tenderit me titull "Furnizim me implante për Klinikën e Ortopedisë dhe Traumatologjisë kockore" ka konstatuar të dhënat si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 22 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar vetëm 9 OE.

AKK ka konstatuar se për **Lot 1** kanë ofertuar 5 Operatorë ekonomik ku vetëm njeri prej tyre që ka tenderuar për këtë lot ka qenë i përgjegjshëm, ndërsa 4 OE tjerë njëri janë të përgjegjshëm pasi që nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nga ana e autoritetit kontraktues.

Lidhur me **Lot 2** Agjencia ka konstatuar se për këtë lot kanë tenderuar 6 Operator Ekonomik ku vetëm njëri nga këta është i përgjegjshëm duke plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, ndërsa 5 të tjerët nuk janë të përgjegjshëm pasi që nuk i përmbush të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Edhe për **Lot 3** Agjencia ka konstatuar se për këtë lot kanë tenderuar 3 Operatorë Ekonomik ku vetëm njëri nga këta që ka tenderuar për këtë lot është

i përgjegjshëm, ndërsa 2 prej tyre nuk janë të përgjegjshëm pasi që nuk i përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Ndërsa për **Lot 4** nga Agjencia është konstatuar se për këtë lot ofertat e tyre i kanë dorëzuar 7 OE. ku 2 prej tyre që kanë tenderuar për këtë lot janë të përgjegjshëm, ndërsa 5 prej tyre nuk janë të përgjegjshëm pasi që nuk i përmbush të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Për **Lot 5** nga Agjencia është konstatuar se për këtë lot ofertat e tyre i kanë dorëzuar 5 OE. ku nga këto vetëm njëra ofertë është e përgjegjshme e cila i ka plotësuar të gjitha kriteret administrative, teknike dhe financiare të kërkuara në dosjen e tenderit, ndërsa 4 prej tyre nuk janë të përgjegjshëm pasi që nuk i përmbush të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Sipas detyrës zyrtare Agjencia ka zhvilluar edhe takime me mjekët nga njësia e kërkesës për të kërkuar sqarime më të hollësishme rreth çështjes së përgatitjes së specifikave. Zyrtarët nga Agjencia kanë kërkuar nga këta mjek që tua argumentojnë faktin që specifikat e përpiluara në atë formë i përmbushim edhe prodhues të njohur botërorë. Kështu mjekët nga njësia e kërkesës kanë sjellur në Agjenci linçet me të cilët kanë argumentuar se janë të paktën edhe 3-4 prodhues të tjerë që i plotësojnë këto specifika, por se qasja në internet në katalogët e disa nga prodhuesve të tillë është më e vështirë dhe mundëson qasjen vetëm për persona të autorizuar për shkak të rrezikut të kopjimit të katalogëve nga ana e prodhuesve të ndryshe Kinez e të tjerë.

Si përfundim Agjencia konsideron se Specifikat e këtij aktiviteti janë mjaftë komplekse dhe vështirë të kuptohen në saktësi nga persona të profesioneve tjera dhe për këtë arsye i mbetet përgjegjësi e plotë Njesisë së Kërkesës konkretisht hartuesve të këtyre specifikave.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar dhe ekzaminuar me kujdes dokumentacionin e ofruar lidhur me këtë procedurë të prokurimit dhe pas monitorimit që ka bërë në vlerësimin e këtij tenderit, komunikimi me njesinë

kërkuese nuk ka gjetur prova të mjaftueshme me të cilat do të evidentohet ndonjë shkelje e dispozitave të LPP-së.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr.03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !

